

SHFAQJE TË PROBLEMATIKAVE TË GJUHËS SHQIPE NË TEKSTET E INFORMATIKËS SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Meleq SHOPI¹, Denis HIMÇI², Heldi KODRA³

¹ Faculty of Human Sciences, University of Elbasan

^{*}Corresponding author e-mail: melishopi64@gmail.com, denishimci@hotmail.com, kodra.heldi06@gmail.com

Abstrakt

Shoqëria shqiptare në dy dekadat e fundit ka ndryshuar si rezultat i dukurive të reja në aspektin ekonomik, politik dhe kulturor. Ndryshimet në jetën e çdo shqiptari, vihen re jo vetëm në mënyrën e jetesës, në marrëdhëniet ndërshoqërore, por edhe në mënyrën e komunikimit dhe të të folurit. Arsyejt drejt prirjes së rritjes së aftësisë të të shprehurit të individit në ndikimin e dukurive të reja shoqërore kanë të bëjnë përpos të gjithave edhe me informatizimin e jetës sonë dhe me kulturën e sotme të rrjeteve shoqërore virtuale. Pra, marrja dhe dhënia e informacionit përmes teknologjisë bashkëkohore, mënyra e komunikimit në situata të ndryshme ligjërimore përmes dy a tri gjuhëve, përdorimi dhe futja e leksemave të reja, krijimi i fjalëve të reja dhe riaktivizimi i atyre të përdorura në vitet para tranzicionit etj., e tregojnë më së qarti formimin gjuhësor dhe cilësinë e vërtetë të ligjërimit.

Po ç'ndodh sot me tekstet e informatikës, të cilat përcjellin gjuhën e teknikës dhe të informacionit përmes gjuhës shqipe? Artikulli ynë ka si qëllim të pasqyrojë pikërisht shfaqje dhe problematika të përdorimit dhe mospërkthimit në gjuhën shqipe i fjalëve të ndryshme nga anglishtja në tekstet e informatikës së arsimit parauniversitar. Fjalë të tilla përkrijnë me kuptimin e fjalëve në gjuhën shqipe, prandaj përdorimi i tyre në këto tekste nuk gjejnë vendin e tyre përkatës. Materiali i vjelë do të renditet në artikull në formën e një fjalorthi dhe do të analizohet përmes shembujve dhe konkretizimit të tyre. Gjuha shqipe e folur dhe e shkruar me kujdes përbën një vlerë dhe nëse nuk e mbrojmë atë nga "përbaltja", atëherë kthehet në të kundërtën e vet.

Fjalët çelës: Gjuha shqipe, informatika, anglicizmat, termat, tekstet.

Marrë shkas nga tematika e kësaj konference, e cila është mjaft bashkëkohore, dua të parashtoj një nga shqetësimet më të mëdha për kohën që jetojmë, jo vetëm për fëmijët tanë, por për të gjithë shoqërinë, që ka të bëjë pikërisht me deformimet dhe mosvlerësimet e duhura të të shkruarit dhe të folurit të gjuhës shqipe në situata të ndryshme ligjërimore.

Trajtimi i kësaj tematike nuk është një gjë anësore. Përkundrazi. Të gjithë sot jemi nën trysinë e shkëmbimeve dhe "fryteve" të internetit. Edhe nga interneti, sot për sot, na vijnë shumë mënyra të thëni, shumë fjalë e forma fjalësh që nuk janë në përshtatje me natyrën e shqipes, por që, për fat të keq, ato kanë përparësinë se pranohen pa një pa dy në shumë mjedise jo vetëm në kumtimet *on-line* e në faqet e *ueb-it*, po edhe në botime me karakter shkollor, universitar, në reklama, në mbishkrime udhësh, sheshesh e institucionesh dhe, deri në botime zyrtare.

Mjaft të hedhim një sy mbi faqet zyrtare të dikastereve e deri të kryeministrisë. Ka gjithandej, sikundër kemi qëllimin e pasqyrimin të këtyre problemeve drejtshkrimore, në hullinë e teksteve të informatikës të përdorura nga nxënësit e shkollave të arsimit parauniversitar. Unë personalisht, duke ndjekur djalin në lëndët që zhvillojnë, midis të tjerave edhe lëndën e informatikës, kam vënë re bashkë me të njëkohësisht që terminologjia e teknologjisë së informacionit, problemet e shqipërimit të fjalëve të huaja në këto tekste lë për të dëshiruar. Fakti është se ne kemi një gjuhë të mirë, në mos jo shumë të pastër, gjithsesi jo aq të varfër sa ta përbuzim e ta bastardojmë, siç citon prof. akademiku Gjovalin Shkurtaj, por **kemi mungesë kulture njërëzore**, e cila, pikë së pari, **pasqyrohet në mungesën e kulturës ligjërimore e shkrimore**. Interneti sot është **prurësi më i shpejtë**, po edhe më i pari i shpikjeve të reja.

Këto risi teknologjike, pavarësisht se ku e kanë zanafillën a burimin e parë, jepen së fundmi kryesisht (për të mos thënë tërësisht) në anglisht e nëpërmjet internetit. Kur është shpikur mjeti motorik që tërheq plugjet në arë për të lëruar, prashitur etj., prodhuesit e kanë sajuar nga folja **trarre** “*tërheq*” dhe në italishten është forma **trattore**. Kurse te ne, duke qenë se e kemi marrë atë mjet, jo nga vendi fqinj, por nga Rusia, bashkë me objektin kemi marrë edhe formën emërtimin, që, në rastin konkret është **traktor** (nga rusishtja) dhe ashtu ka mbetur edhe sot e gjithë ditën. (cit.akad.prof.Gj. Shkurtaj). Në vitet e fundit, sikundër po shihet, fjalët e reja (qofshin të nevojshme apo të panevojshme) po hyjnë nëpërmjet anglishtes, sepse anglishtja është gjuha kryesore (për të mos thënë gati e vetmja) e shkrimeve dhe kumtimeve në internet.

Kjo, duke mos e zgatur, vlerësoj se ka një të mirë të madhe: përhapjen e shpejtë dhe me karakter të gjerë global, por ka edhe një të keqe shumë të madhe që është, kryesisht për shqipen e për gjuhët që kanë sistemin e eptimit të emrave. Anglishtja, si dhe gjuhë të tjera, nuk ka lakim të emrave, as të emrave të përgjithshëm, as të emrave të përveçëm, dhe kjo, ndërsa për shumë gjuhë të tjera nuk krijon probleme, por për shqipen e strukturën gramatikore të shqipes krijon një problem shumë të madh apo, *krijon prishjen e paradigmës eptimore që është e krahasueshme me “plasaritjen e digës” në ujëmbledhësit e hidrocentraleve. Plasaritja zgjerohet dhe vjen dita që diga do të çahet*- shkruan prof. akademiku Gjovalin Shkurtaj në shkrimet e veta. Pikërisht artikulli ynë do të përcjellë përmes një analize gjuhësore këtë fenomen në botimet shkollore të arsimit parauniversitar, tekste që ndikojnë drejtpërsëdrejti në formimin tekniko-shkencor, nga njëra anë, por edhe atë gjuhësor e kulturor të të rinjve tanë.

Janë shfrytëzuar si materiale faktike terminologjia e teksteve të informatikës nga klasa e 8-të e deri te klasa e 12-të. Problemet gjuhësore që janë të dukshme në këto tekste janë të llojeve të ndryshme. Në justifikimin për një “*ekonomizim të kohës*” përkthyesit përdorin shërbimin “*Google Translate*” ku vihen re përkthime të dobëta të teksteve, artikujve dhe pse jo edhe botime. Nuk mund të flitet më për një redaktim apo përshtatje të rregullave drejtshkrimore, për përdorim të leksikut të përshtatshëm me shqipen apo deri në gabime logjike. Por ajo që bie më tepër në sy është përdorimi i fjalëve dhe përkthimi i tyre nga anglishtja në shqip, duke mos analizuar anën kuptimore në lidhje me kontekstin në të cilin përdoret nga ligjëruesi.

P.sh. në tekstin e klasës së 12-të¹²⁸, shkruhet: ...*në Python trupi i shprehjes if tregohet nga dhëmbëzimi i tekstit*. Grupi emëror “*dhëmbëzimi i tekstit??*” është kryer nga faqja “*Google Translate*”, pasi ka të bëjë me *nxjerrja në kryeradhë e tekstit*. Përkthime të tilla sidomos ato që kanë të bëjnë edhe me figurshmërinë letrare të tilla si: mund të ngjasojë shumë me *kërkimin e gjilpërës në stomakun e sanës* ...ku shprehja në gjuhën shqipe i përket: *në kërkimin e gjilpërës në kashtë*”. *Për drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në shqipen, gjithashtu, mendojmë se në këto tekste dukuria është trajtuar shumë qartë e drejt. Nuk më duket i drejtë mendimi (madje edhe synimi) i disave që kërkojnë të mbeten ashtu si shkruhen në anglishten e në gjuhën prej nga huazohen. Ky problem, në fakt, del edhe kur është fjala për hartimin e fjalorëve.

¹²⁸ A. Myderrizi, A. Gogu, *Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit 12 (me zgjedhje, për arsimin e mesëm dhe të përgjithshëm)*, Pegi, Tiranë, 2018, f.44.

Ka pasur e ka mendime se anglicizmat duhet të shkruhen në fjalor me grafinë që kanë në gjuhën dhënëse. Zgjidhja më e përshtatshme na duket ajo që është bërë tashmë edhe një traditë e drejtshkrimit të fjalëve të huaja në shqipen. Fjalët e huaja dhe emrat e perveçëm të huaj, të pranuar në gjuhën shqipe, do të shkruhen sipas shqiptimit që kanë në gjuhën dhënëse, por sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes. Në këtë hulli mbetet të paraqesin probleme drejtshkrimore edhe shkurtesat (Akronimet). Zakonisht shkurtesat që lidhen me diskursin juridik, politik, ekonomik, kulturor përballen me përkthime. P.sh. FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar), WB (World Bank) ose SQBDH(Sistem i Qeverisjes së Bazës së të dhënave) etj. Në tekstet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit shkurtesat nuk përkthehen, si të tilla ato njihen botërisht në formën e tyre origjinale, p.sh. *IP* (Internet Protokoll, protokoll i internetit), *VPN*(Virtual Private Network, rrjet privat virtual) etj.

Pra, shkurtesat në gjuhë të huaj duhet të shkruhen siç paraqiten në gjuhën dhënëse, por ajo që është e rëndësishme dhe për t'u vënë në pah është që të shkruhet në kllapa emërtimi i plotë bashkë me përkthimin në shqip, si në shembujt e mësipërm. Një tjetër çështje që lidhet me problemet gjuhësore në fushën kompjuterike është emërtimi i komandave, emërtimi i veprimeve në postën elektronike, veprimeve në internet ku gjithsecili prej nesh kryen dhe ndërvepron sipas sistemeve përkatëse, të cilat janë njëkohësisht të përgjithshme për çdo lloj kompjuteri. Edhe këtu në lidhje me përkthimin vihen re deformime të fjalës shqipe. Për ta bërë sa më konkret problemin po japim një pasqyrë të këtyre emërtimeve ku fjala në gjuhën angleze nuk gjen përkthimin e duhur, përkatës në gjuhën shqipe ose nuk përshtatet me formën gramatikore përkatëse në të tilla raste si:

close - komanda më e shpeshtë në veprimet kompjuterike, sistem apo program kompjuterik. Përkthimi i duhur i kësaj foljeje, meqë përbën dhe një komandë në mbylljen e një dritareje grafike është në mënyrën urdhërore, që do të thotë : **mbyll**. Dhe jo **-mbyllje**-. Pra, nga folje përkthehet si emër. Po kështu edhe për rastet si më poshtë:

cut-pre dhe jo *pres* apo *prerje*; **delete-fshi** dhe jo *fshij* apo *fshirje*; **open-hap** dhe jo *hapje*. **Preview**- e cila del me komandën e shtypjes, përkthimi i saj do të jetë **shfaq prova**.

Print, - komandë që shërben për shtypjen e materialit në letër përkthehet **shkruaj** dhe jo *shtyp* apo *shtypje*;

Run - mbyll, kryej. Në tekste e gjejmë *ekzekutoj*;

Forward.- dërgo. Në tekste e gjejmë- *ecje përpara* ose *përparo*;

Unsend- prapëso, kthe mbrapsht. Në tekste e gjejmë *zhdergoj*;

Subsscribe.- çregjistro. Në tekste e gjejmë *pajtohem*;

Licencë - leje, lejim. Në tekste e gjejmë *liçensë, liçensoj, liçensim*;¹²⁹

Agjenda- ditar, rend dite. Në tekst e gjejmë *axhendë*;¹³⁰

Digital(digjital dhe jo *dixhital* në gjuhën e folur dhe të shkruar)¹³¹ ;Në tekste e gjejmë **digital**¹³² që është përsëri një shkelje e normës drejtshkrimore.

Back-door - arkapi, kapaxhë, birucë;

Bookmark.- shënues. Në tekste e gjejmë *Bookmark(shënim i faqes)*;

Cluster-shtyllë, rresht. Në tekste e gjejmë të papërkthyer në format *klaster* ose *cluster*.¹³³

¹²⁹ Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu, Entela Jegeni: *Informatika 3* (drejtimi natyror);Tiranë, 2008; Marenglen Bukli, Genc Brahimaj, Silvana Greca, Indrit Baholli: *TIK i Avancuar* (Për klasën e 11-të të gjimnazit, kurrikula me zgjedhje e detyruar), Tiranë, 2010.

¹³⁰Frederik Shalësi,Ilia Ninka,Eqerem Arkaxhiu, *Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit* (për klasën e 10-të), Tiranë 2011.

¹³¹ Ilia Ninka,Eqerem Arkaxhiu, Frederik Shalësi, *Informatika 4*(Për shkollat e mesme, drejtimi natyror), Tiranë, 2006; Marenglen Bukli, Genc Brahimaj, Esmeralda Tasho, Silvana Greca,*TIK 12-të* (Për klasën e 12-të të gjimnazit, kurrikula me zgjedhje e detyruar), Tiranë, 2011.

¹³² Eqerem Arkaxhiu, Juliana Ahmeti, *Hyrje në Informatikë*, SHBLU, Tiranë, 2007.

¹³³ Neki Frashëri,Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu, *Informatika 1*(Për shkollën e mesme të profilizuar), Tiranë, 2002.

Driver- ngas. Në tekste e gjejmë të papërkthyer *Drive* si njësia e diskut të fortë ose si folje në rastin e dhënë ngas.

Accessible - kaluesh/ëm,-e (i,e).

Log out dhe sign out-dil dhe *jo shkyçu ose ç'logimi*,¹³⁴

Upload- ngarkoj, ngarkim dhe *jo transferoj apo transferim*¹³⁵.

Së fundmi, një nga problemet që paraqesin tekstet e lëndëve të informatikës në arsimin parauniversitar, por jo vetëm, janë dhe problemet në fushën e leksikologjisë e më përkatësisht ato që lidhen ose që kanë të bëjnë me përkthimet dhe përshtatjen e fjalëve nga anglishtja, sidomos ato që prishin strukturën fjalëformuese të gjuhës shqipe, duke e dëmtuar dhe jo pasuruar atë. Nga këto tekste ne kemi vjelë disa prej tyre, të tilla si:

Encapsulation-kjo fjalë po ndeshet në formën *-enkapsulim-*. Pra, e njëjtë me fjalën në anglisht. Por e kemi vënë re edhe në formën *-inkapsulim-*¹³⁶ që përsëri është e gabuar. Forma e rregullt dhe duhur në gjuhën shqipe është- **kapsulim**.

Encode, ku fjala e duhur në gjuhën shqipe është **kodoj** dhe duhet të shmangim përkthimin e gabuar nga gjuha angleze *-enkodoj*.

Encrypt – kriptoj dhe *jo -enkriptoj*.¹³⁷ Pra, nuk del e nevojshme parashtesa *en-* në këtë rast dhe në raste të tjera ku kjo parashtesë është mirëqenë. Kjo dukuri e përdorimit dhe përshtatjes gjatë përkthimit nga gjuha angleze nuk ndodh vetëm me *parashtesat*, por edhe me *parapashtesat* të tilla si: *-al, -acion, -icien-*. Ja disa prej rasteve të përdorimit:

Polynomial- mbiemri në këtë rast duhet të shkruhet me prapashtesën *-ik* e më përkatësisht **polinomik** dhe jo me *-al*¹³⁸. Fjalë të formuara me prapashtesën *-al-* ndeshen edhe në ligjërimin e përgjithshëm ku fjalë si: *kulturor, teatror, muzikor*, që janë përtej stilit tekniko-shkencor, shumë herë i ndeshim në formën e gabuar me prapashtesën *-al-* e më përkatësisht: *kultural, teatral, muzikal*.

-Configuration-konfigurim në gjuhën shqipe dhe *jo konfiguracioni*¹³⁹. Po kështu edhe me fjalë të tjera që ndërtohen me këtë prapashtesë si *emulation- emulim* dhe *jo emulacion, instalation* etj.ndërsa me prapashtesën *-icien-* ndeshim format e gabuara të të shkruarit në këto tekste si *teknicien, elektronikien* etj., ku forma e duhur në gjuhën shqipe i përgjigjen format: *teknik, elektronik* etj.

Pra, në analizën e këtyre shembujve të dhënë, si përfundim del domosdoshmëria e kujdesit ndaj gjuhës së shkruar në dokumentacionin zyrtar, shkollor, mediatik si dhe në të gjitha përdorimet shkrimore që përfshijnë fushat e zhvillimit shoqëror dhe gjuhës në përgjithësi, si një nga vlerat e kulturës sonë kombëtare. Nisur nga qëllimi i këtij artikulli tekstet duhen parë, hartuar dhe reduktuar me përgjegjësinë më të madhe, në shkallën më të lartë të cilësisë së redaktuesit dhe korrektorit gjuhësor.

Një punë me vlera të jashtëzakonshme po bëjnë shqiptarët e Maqedonisë, që mezi kanë fituar një farë të drejte për të përdorur edhe gjuhën shqipe, me të ashtuquajturin **“Inspektoriati gjuhësor”**, që është,në një farë mënyre, si sektori i dikurshëm i **“këshillimeve gjuhësore”** në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, të cilën e kemi lënë në harresë. Të hartohet një platformë për krijimin e një grupi gjuhëtarësh specialistë për të realizuar edhe tek ne **inspektoriatin gjuhësor të shqipes** në botimet zyrtare e në administratën publike.

¹³⁴ Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu, Entela Jegeni: *Informatika 3* (drejtimi natyror);Tiranë, 2008.

¹³⁵ Ada Gogu, Altina Myderizi, *Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit 11-të* (Për arsimin e mesëm të përgjithshëm),Tiranë, 2017.

¹³⁶ Po aty.

¹³⁷Altina Myderizi, Ada Gogu, *Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit 12-të* (Me zgjedhje, për arsimin e mesëm të përgjithshëm),Tiranë, 2018.

¹³⁸ Po aty.

¹³⁹ Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu, Entela Jegeni: *Informatika 3* (drejtimi natyror);Tiranë, 2008, Frederik Shalësi,Ilia Ninka,Eqerem Arkaxhiu, *Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit* (për klasën e 10-të), Tiranë 2011.

Është e pafalshme që po përdoren terma të gabuar dhe kundër natyrës së shqipes, si *dakordësim* në vend të *marrëveshje* apo *ankimim* në vend të *ankesë* apo thjeshtë *ankim*; *dividenti* në vend të *përndarja* apo *shpërndarja e të ardhurave* etj. Ndaj gabimeve e shkeljeve të pafalshme e të përditshme të rregullave të shqipes së shkruar e të gramatikës së gjuhës sonë, po tregohemi të pandjeshëm e, madje, neglizhues. Shqiptarët e Maqedonisë, ndonëse janë pakicë gjuhësore e etnike, po kërkojnë e po punojnë me ngulm për mbrojtjen e shqipes zyrtarisht. Ne duhet patjetër të krijohet, një komision a grup pune pikërisht për mbrojtjen e gjuhës, duke mos lejuar gjendjen e pakujdesisë dhe gabimeve trashanike që po bëhen në faqet zyrtare të institucioneve shtetërore, në botimin e librave dhe në gazetarinë e shkruar e të folur.

Me ngut e me përgjegjësinë e duhur kërkohet të pastrohen e të rishikohen nga ana gjuhësore reklamat e televizioneve dhe titujt e titullimet e rubrikave, shumica e të cilave janë padrejtësisht e pa asnjë motivim bindës vetëm në gjuhë të huaja. Në jetësimin dhe krijimin e një bërthame studimore e kërkimore për mbrojtjen e shqipes duhet të punohet me shumë kujdes e duke siguruar patjetër edhe bashkërendimin me institucione si Këshilli Ndërkademi i Gjuhës Shqipe. Ndërkaq, me punën dhe shtjellimet e një grupi pune pranë Akademisë, patjetër, duhet të jepet shembulli për një përkujdesje të gjuhës shqipe, ashtu si po bëhet në Maqedoni për mbrojtjen dhe zbatimin e gjuhës shqipe në të gjithë praktikën shkrimore e botuese të Republikës së Shqipërisë.

Referencat

- [1]. Bukli, M., Brahimaj, G., Greca, S., Baholli I.,: 2010. *TIK i Avancuar* (Për klasën e 11-të të gjimnazit, kurrikula me zgjedhje e detyruar), Tiranë.
- [2]. Frashëri, N., Ninka, I., Arkaxhiu, E., 2002. *Informatika 1*(Për shkollën e mesme të profilizuar), Tiranë,
- [3]. Gogu, A., Myderizi, A., 2017. *Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit 11-të* (Për arsimin e mesëm të përgjithshëm), Tiranë.
- [4]. Myderizi, A., Gogu, A.,*Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit 12 (me zgjedhje, për arsimin e mesëm dhe të përgjithshëm)*,Pegi, Tiranë.
- [5]. Ninka, I., Arkaxhiu, E., Jegeni, E., : 2008. *Informatika 3* (drejtimi natyror); Tiranë.
- [6]. Smaçi, E., N., Ilia, 2019. *TIK (Teknologjia e informacionit dhe komunikimit)*, Kl. 8-të,Tiranë.
- [7]. Shalësi, F., Ninka, I., Arkaxhiu, E., 2011. *Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit* (për klasën e 10-të), Tiranë.
- [8]. *Propozime për Drejtshkrimin I, II*, 2021. Tiranë.
- [9]. Shkurtaç, Gj., 2022. *Kultura e gjuhës sot(Përmbledhje studimesh dhe pjesë tekstesh universitare)*, Tiranë.
- [10]. Shkurtaç, Gj., 2017. *Urgjenca gjuhësore*, Tiranë.
- [11]. Shkurtaç, Gj., 2008. *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë.